



ALB-AUDIT

ALB-AUDIT sh.p.k

Rr. EMIN DURAKU
Nd.2, H. 6 , Ap. 10
Njësia Bashkiake Nr.5 , Kodi Postar 1019
TIRANË
NIPT : L 01417011 K
Tel/fax +35542251744 , Cel . 0692042251
Email.albaudit@gmail.com :hsulaj@yahoo.com .

Për ;KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Rruga; "Ibrahim Rrugova", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri

LëndaInformacion për mosrealizimin e auditimit ligjor të detyrueshëm të
: fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore në
Organet e Qeverisjes Vendore 2019, të Partisë, ALEANCA PER
BARAZI DHE DREJTESI EUROPIANE(ABDE).

Të nderuar zotërinj,

Me vendimin Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve(KQZ) nr. 740, datë
31.05.2019 dhe kontratës së shërbimit në zbatim të tij, jam angazhuar në
cilesinë e Audituesit Ligjor për misionin me objekt:

- Kryerjen e monitorimit të shpenzimeve të fushatës zgjedhore të partive politike dhe,
- Kryerjen e auditimit ligjor të detyrueshëm të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore, për zgjedhjet në Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30.06.2019, nga Partia, ALEANCA PER BARAZI DHE DREJTESI EUROPIANE(ABDE).

Për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, menjëherë pas lidhjes së kontratës me KQZ-në, më datë 01.06.2019, ne kërkuam dhe vendosëm komunikimin zyrtar me drejtuesit e Partinë, ALEANCA PER BARAZI DHE DREJTESI EUROPIANE(ABDE), të cilët qenë bashkëpunues gjatë procesit të monitorimit dhe na deklaruan se për fushatën zgjedhore

vendore 2019 nuk do të zhvillojnë asnjë aktivitet dhe për rrjedhim nuk kishin parashikuar të ardhura dhe shpenzime në funksion të fushatës.

Por pavarësisht informacioneve dhe deklarimeve të partisë për mungesën e plotë të aktiviteteve elektorale, ne vazhduam procesin e monitorimit në terren për përmbushjen e objektit të parë të kontratës, kryerjen e monitorimit të shpenzimeve të fushatës zgjedhore.

Ashtu siç është përshkruar dhe në raportin e hartuar për këtë çështje, si nga deklaratimet e partisë dhe nga monitorimi në terren i aktivitetit elektorale, rezultoi se Partia, ALEANCA PER BARAZI DHE DREJTESI EUROPIANE(ABDE), nuk ka zhvilluar asnjë aktivitet zgjedhor dhe nuk ka realizuar të ardhura dhe kryer shpenzime për fushatën zgjedhore vendore 2019.

Në kushtet e mungesës së plotë të aktiviteteve elektorale, dokumenteve dhe transaksioneve për të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me fushatën zgjedhore, objekti i kontratës për “Kryerjen e auditimit ligjor të detyrueshëm të fondeve të përftuara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore, për zgjedhjet në Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30.06.2019, nga Partia, ALEANCA PER BARAZI DHE DREJTESI EUROPIANE(ABDE), nuk është realizuar.

1. Bashkangjitur shkresa e dërguar në mënyrë elektronike nga Kryetari i Partisë ALEANCA PER BARAZI DHE DREJTESI EUROPIANE(ABDE).

Faleminderit për mirkuptimin.

Tirane, me 20.11.2019

AUDITUES LIGJOR

Hetem SULAJ

The image shows an official stamp of ALBAUDIT TIRANA, which includes a logo with a scale of justice and the text 'ALBAUDIT' and 'TIRANA'. Overlaid on the stamp is a handwritten signature in blue ink.